

## Obligimi tatimor


Secili nga ne në Kosovë shfrytëzohet shërbime të shumta nga shteti si: siguri, shëndetësi, arsim, infrastrukturë, etj. Sigurisht se këto shërbime kanë kosto, e cila mbulohet me tatime, taksa dhe pagesa që i kryejmë ndaj shtetit tonë. Kështu që secili qytetar, rezident apo biznes që krijon të mira materiale duhet të paguajë një pjesë të drejtë ndaj shtetit.


 ATK - Administrata Tatimore e Kosovës.

## Krijimi i borxhit

Sistemi tatimor i Kosovës është i bazuar në përmbushjen vullnetare dhe vetë-deklarim. Një borxh tatimor (obligimi juaj) krijohet kur:

- deklaroni dhe nuk paguani;
- vonoheni në deklarim dhe pagesë;
- ATK bën një përcaktim shtesë për mosdeklarim, nën-deklarim, ndëshkim apo interes

 Me termin tatim përfshihen edhe kontributet pensionale apo kontributet tjera që mund t'i jepen si obligim ATK-së t'i mbledh.

 Çdo vonesë në kryerjen e obligimeve ose pagesë të tatimeve pasohet me rrjedhjen e ndëshkimeve dhe interesit në baza mujore.

## Rasti për mbledhje

Kur është krijuar një borxh tatimor dhe është bërë i pagueshëm, caktohet rasti në mbledhjen e detyrueshme, e cila përbrenda autorizimeve të dhëna do të mbledh borxhin tatimor dhe do të kërkojë deklaratat në mungesë. Afati i mbledhjes së një borxhi tatimor është 6 (gjashtë) vite nga data e vlerësimit të tatimit. Kjo periudhë mund të zgjatet nëse:

- Keni parashtruar ankesë në Departamentin e Ankesave në ATK
- Keni parashtruar ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime
- Keni parashtruar ankesë në një gjyq të juridiksionit kompetent
- Jeni Ndërmarrje Publike (pakufi)
- Jeni Ndërmarrje Shoqërore (deri në likuidim)
- Jeni jashtë vendit më shumë se tre (3) muaj
- Keni bërë marrëveshje me shkrim me ATK-në për zgjatje të periudhës (por jo më shumë se 24 muaj)

## Autorizimet e ATK-së

Sa i përket mbledhjes së tatimit, Administrata Tatimore e Kosovës ka autorizime të shumta të cilat janë të parapara me ligjet tatimore, e ato janë:

- Kërkimi i informatave për pasurinë tuaj si nga ju ashtu edhe nga palët tjera (përfshirë bankat)
- Regjistrimi i barrës tatimore (në tërë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme), **10 ditë pas krijimit të borxhit tatimor me efekt 6 vjeçar.**

- Bllokimi i llogarive bankare dhe konfiskimi i mjeteve në to
- Bllokimi dhe konfiskimi i mjeteve të pritura nga klientët apo punëdhënësit tuaj
- Bllokimi i mallrave për import apo eksport
- Mos-lejimi për largim nga Kosova
- Konfiskimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme (**me përjashtim të gjësendeve themelore për jetesë të familjes**)
- Shitja e pasurisë së konfiskuar
- Ndjekja penale

 Për çdo përcaktim apo vendim ATK ju informon me detajet dhe bazën ligjore dhe ju jep afat që ju të kryeni detyrimet tuaja.

## Pagesa e borxhit tatimor

Opsioni i parë është që të shikoni se a keni mundësi të kryeni pagesën në tërësi. Nëse keni vështirësi financiare, do të ishte më e leverdishme që të merrni kredi nga bankat apo burime tjera huadhënëse, për të paguar tatimet, për shkak se rrjedhja e interesit dhe ndëshkimeve me ATK-në tejkalon shkallën e interesit të bankave. Çdo pagesë që bëni, qoftë e tërësishme apo pjesëshme, do të ndikojë në uljen e tatimit bazë e më të edhe të ndëshkimeve dhe interesit.

- Nëse jeni në mbi-pagesë, ATK ka të drejtë ta aplikoj atë në borxh.
- Nëse jeni në kreditim të TVSH, ATK mund të hap kontroll dhe kreditimin e vlefshëm ta aplikoj ndaj borxhit.
- Këto procese mund t'i inicioni edhe ju me anë të kërkesës me shkrim.

Kur të jetë kryer pagesa ajo do të aplikohet me këtë renditje:

1. Shpenzimet e mbledhjes
2. Shuma e çdo detyrimi tatimor
3. Sanksionet dhe pagesat ndëshkuese
4. Interesi.

 Të gjitha tatimet paguhen në banka apo institucione financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK)


## Marrëveshjet me këste

Kur ju keni vështirësi financiare dhe ato ia provoni ATK-së, ATK mund të ju mundësojë që ju të hyni në marrëveshje të pagesës së detyrimit tuaj në këste.

Ligji parasheh që nëse bëni kërkesë për marrëveshje të paguani:

- 20% të borxhit të përgjithshëm,
- në 2 (dy) a më shumë këste,
- brenda 12 muajve, dhe
- kryeni detyrimet tjera brenda periudhës së marrëveshjes,

ndëshkimet për mos-deklarim (5% në muaj, deri në maksimum 25% në bazën tatimore) dhe mos-pagesë (1% në muaj, deri në maksimum 12% në bazën tatimore), të cilat nuk janë të njëkohshme, do të ulen në dy përqind (2%) të detyrimit tatimor dhe interesi (1.25% në muaj) do të ndalet së rrjedhuri. Me mos-respektimin e marrëveshjes ju humbni këto përfitime.

 Marrëveshjet me kushte tjera nuk ju japin të gjitha këto lehtësime.

## Si të merren formularët

Për të deklaruar dhe paguar tatimin ju duhet të merrni dokumentet përkatëse nga ATK. Këtë mund ta bëni nga faqja e internetit të ATK-së: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) në linkun **Shkarko deklaratë elektronike**. Por deklaratat dhe fletë-pagesat mund të shkarkohen VETËM kur të keni numrin fiskal, të cilin duhet ta siguronit paraprakisht në Administratën Tatimore të Kosovës. Kur të shkarkoni formularët, shkarkoni vetëm formularët që aplikohen për ju dhe siguronit që të kërkonti llojin dhe periudhën e saktë tatimore.

## Lehtësimi nga ndëshkimet

Në qoftë se detyrimi tatimor i lindur ka qenë për shkaqe të arsyeshme, ushtrim të besimit të madh, vështirësi të madhe apo arsye tjera të forta, ju mund të paraqitni një kërkesë me gjitha arsyet dhe provat pranë ATK për lehtësim nga ndëshkimet.

## Ankesat

Nëse besoni se vendimi, përcaktimi apo dokumenti i nxjerrë nga ATK përmban shkelje procedurale, gabime faktike ose ligjore, mungesë dëshmie apo mungesë materiale, ju mund të parashtroni ankesë së bashku me provat dhe dokumentacionin tuaj, brenda 30 ditëve nga data e nxjerrës së tyre, në Departamentin e Ankesave (DA) pranë ATK. Departamenti i Ankesave ka për obligim të ju kthejë përgjigje brenda 60 ditëve.


Departamenti i Ankesave ndodhet në Zyrat Qendrore të ATK-së.

Nëse edhe më tutje besoni se vendimi nga DA nuk është i drejtë, ju keni të drejtë të ankoheni në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime (BPR) (brenda 30 ditëve nga pranimi i vendimit të DA), apo me tutje në Gjykatën e juridiksionit kompetent (brenda 60 ditëve nga pranimi i vendimit të BPR).

## Avokati i Tatimpaguesit

Kur nuk keni marrë përgjigje që keni kërkuar, kur deklaratat apo pagesat tuaja nuk janë përpunuar me kohë, kur materialet e ofruara nga ju nuk merren parasysh, kur mbledhja e një borxhi mund të dëmtojë një të pafajshëm, e të ngjashme, ATK ka bërë të mundur që çështjet e këtuja të mund t'i paraqitni tek Avokati i Tatimpaguesit që gjendet në Zyrat Qendrore të ATK-së.


Ju mund ta kontaktoni Avokatin e Tatimpaguesit përmes: email-it: [avokati.tatimpaguesve@atk-ks.org](mailto:avokati.tatimpaguesve@atk-ks.org), apo ta thirrni në numrin e telefonit: **+381 38 200 347 09**.

 Avokati i Tatimpaguesit **nuk** është ndonjë shkallë e ankesave

**Konfidencialiteti (besueshmëria)**

Me qëllim që ATK të bëjë përcaktim sa më të saktë dhe korrekt të obligimeve tuaja tatimore, ajo nga ju dhe palët tjera merr informata të shumta, të cilat po nuk u ofruan pasohen me gjopa dhe ndëshkime. Këto informata mundën t'u shpërndahen institucioneve tjera të cilave u lejohet me ligj si:

- Ministrisë së Financave
- Entit të Statistikave të Kosovës
- Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës
- Institucionit të Ombudspersonit
- Zyrës së Prokurorisë Publike
- Gjykatave
- Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve
- Zyrës së Auditori Gjeneral
- Doganave
- Autoriteteve tatimore të një vendi të huaj nën traktat
- Medieve dhe publikut në raste shumë specifike

 Ju me shkrim mund të lironi çdo person nga detyrimi i konfidencialitetit. Çdo shpalosje tjetër e informatave të tatimpaguesit është rreptësisht e ndaluar me ligj

**Obligimi tatimor për personat e tretë**


Kur dikush ka qenë përgjegjës apo ka ndihmuar në mos-kryerjen e detyrimeve tatimore, ATK ka autorizime që ndaj atyre personave të bëjë vlerësim tatimor dhe të ndjek të gjitha procedurat që kërkohen sikurse ndaj çdo tatimpaguesi tjetër që është në detyrim ndaj ATK-së. Ata/ato mund të jenë:

- Person përgjegjës (në biznes që ka pasur përgjegjësi të kryej obligimet tatimore);
- Transfer-marrës (person që ka mundësuar transferimin e aseteve të obliguesit tatimor);
- Pronar përfitues (i cili gëzon përfitimet nga dominimi dhe kontrolli i aseteve me titull në pronësi të tjetërkujt);
- I emëruar (dikush i caktuar të veprojë për tjetërkënd).

**Tatimi në rrezik**

Kurdo që ATK konsideron se pagesa e tatimit që është obligim është në rrezik mund të lëshojë urdhër për tatim në rrezik kur:

- tatimpaguesi është gati të lëshojë Kosovën;
- tatimpaguesi është gati të pushojë biznesin;
- tatimpaguesi është gati të transferojë pasurinë; apo;
- arsye tjera të ngjashme të dokumentuara.

 Kur urdhri për tatim në rrezik është lëshuar, njoftohet çdo person që i ka borxh para apo pasuri tatimpaguesit që të lë mënjanë paratë apo pasurinë e atij tatimpaguesi deri në njoftimin tjetër.

# Paguaj tatimin, fli rehat!

**Qendra e Thirrjeve**

Përveç informimeve me postë, kontaktit të drejtpërdrejtë me punëtorët e ATK, ju mund të thirreni me telefon nga punëtorët tanë në Qendrën e Thirrjeve. Ata do të ju informojnë juve mbi borxhin tatimor dhe deklaratat me mungesë, si dhe do të ju kërkojë dhe ndihmojë të kryeni pagesën dhe deklarimet e tatimit, ashtu që gjendja juaj me ATK-në të jetë e pastruar.

**Integriteti i ATK-së**

Në rast se hasni sjellje të keqe, veprime tjera që qojnë në korrupsion, keqpërdorim detyre apo paraqet kërcënim sigurie të punëtorëve të ATK-së apo qytetarëve lajmëroni falas në numrin vijues:

**0800-80-800**

Zyra e Standardeve Profesionale do të merret dhe hetojë rastin nën diskrecionin maksimal.

**Kontakti**

Për informata më të hollësishme apo çështje që lidhen me borxhet tatimore apo procesin e mbledhjes, ju mund ta bëni duke kërkuar në faqen e internetit të ATK-së, [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) apo duke kontaktuar nëpër zyrat tona regjionale dhe Zyrat Qendrore në adresat dhe numrat e telefonave:

Regjionet	Numrat e telefonave	Adresat
Prishtina-1	038 / 200 255 55	Rruga: Nënë Tereza, objekti i ish Gërmisë
Prishtina-2	038 / 200 255 57	Rruga: Nënë Tereza, objekti i ish Gërmisë
Prishtina-3	038 / 200 255 16	Rruga: Fehmi Agani 39
Prizreni	029 / 231 612	Rruga: William Walker PN
Peja	039 / 423 430	Sheshi: Skënderbeu PN
Ferizaj	0290 / 322 302	Rruga: Dëshmorët e Kombit PN
Gjilani	0280 / 326 967	Rruga: Skënderbeu PN
Mitrovica	028 / 533 648	Rruga: Agim Hajrizi PN
Gjakova	0390 / 330 057	Rruga: Nënë Tereza PN
NjTM	038 / 200 255 29	Rruga: Fehmi Agani 41
Zyra Qendrore	038 / 200 347 07	Këndi i Rrugëve Dëshmorët e Kombit dhe Bill Clinton; 10 000 Prishtinë, Kosovë

info@atk-ks.org

www.atk-ks.org



Administrata Tatimore e Kosovës  
Poreska Administracija Kosova  
Tax Administration of Kosovo

## INFORMATA PËR BORXHIN TATIMOR

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Përbushje vullnetare  
të obligimeveShërbime profesionale,  
transparente dhe efektiveZbatim të drejtë dhe të  
njëlloshëm të ligjeve tatimore